



Funded by
the European Union



IPLS | institute for policy
& legal studies



RAPORT MONITORIMI

Zgjedhjet e Përgjithshme Parlamentare 2025

Qarku Shkodër dhe Qarku Lezhë

Copyright..... Consulting and Development Partners (Code Partners).

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

Publikimi i këtij raporti është bërë i mundur me mbështetjen e projektit “Pjesëmarrja e OShC-ve në proceset zgjedhore për një demokraci më të fortë dhe përshpejtimin e integritetit në BE”, financuar nga Bashkimi Evropian, zbatuar nga Qendra Kombëtare Burimore e Trajnimit dhe Asistencës Teknike dhe Instituti për Studime Publike dhe Ligjore.

Opinionet, të gjeturat dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e Consulting and Development Partners dhe jo domosdoshmërisht paraqesin pikëpamjet e donatorit.



Funded by
the European Union



IPLS | institute for policy
& legal studies



PËRMBATJA

Lista e akronimeve.....	3
1. Hyrje.....	4
2. Objektivat e monitorimit.....	4
3. Metodologjia.....	5
4. Konteksti Politik.....	6
5. ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE	6
5.1 dita e zgjedhjeve	6
5.1.1 hapja e qendrës së votimit	6
5.1.2 procesi i votimit.....	6
5.1.3 mbyllja e votimit.....	7
5.2 Qendra e Numërimit.....	8
5.2.1 organizimi i punës për numërimin e votave.....	8
5.2.2 procesi i numërimit.....	9
5.3.2 rezultatet paraprake.....	9
6. Konkluzione	10
7. Anekse.....	10



Funded by
the European Union



IPLS | institute for policy
& legal studies



Lista e akronimeve

Bashkimi Evropian	BE
Consulting and Developmet Partners	Code Partners
Grupet e numërimit të votave	GNV
Komisioni qendror i zgjedhjeve	KQZ
Komisioni zonal i administrimit zgjedhor	KZAZ
Komisioni i qendrës së votimit	KQV
Qendra e votimit	QV
Qendra e numërimit të votave	QNV
Vëzhgues afatshkurtër	VA

.....

1. Hyrje

Ky raport është hartuar në kuadër të projektit *“Elections and the quality of democracy”*, zbatuar nga Consulting and Development Partners mbështetur nga organizata ANTTARC dhe me financim nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Tiranë.

Code Partners është një organizatë jofitimprurese e themeluar në Shkodër, në vitin 2012. Misioni i CODE Partners është të ndikojë në zhvillimin ekonomik, përfshirjen kulturore dhe sociale, duke promovuar zhvillimin e turizmit, duke krijuar mundësi punësimi për grupet e marginalizuara, mbrojtjen e mjedisit dhe forcimin e rrjetëzimit të shoqërisë civile. Organizata ndërmerr iniciativë në përputhje me misionin e saj duke përfshirë përgatitjen dhe zbatimin e projekteve; mbështet aktivitetet e ndërtimit të kapaciteteve institucionale dhe organizon ngjarje të shumta që mobilizojnë opinionin publik, si dhe shpërndanë njohuri dhe qasje inovative në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik duke promovuar rritjen profesionale dhe krijuese për të rinjtë përmes trajnimit, fuqizimit dhe aksesit në treg.

Menjëherë pas njoftimit nga ANTTARC për përzgjedhjen e aplikimi tone, ekipi i projektit filloi procesin e identifikimit të të rinjve që do të përfshiheshin në procesin e monitorimit të zgjedhjeve. Pasi përzgjedhëm ekspertin për organizimin e trajnimeve dhe menjëherë sapo u plotësua numri i parashikuar i vëzhguesve afatshkurtër, filluam procesin e akreditimit të VA-ve nga KQZ.

Përveç monitorimit në terren nga VA, të udhëzuar dhe të mbështetur drejtpërdrejt nga stafi ekzekutiv i Code Partners, të dhënat që i kanë shërbyer këtij raporti paraprak të monitorimit, janë mbështetur gjithashtu në monitorimin e faqeve zyrtare online të institucioneve, ndjekjen e seancave apo mbledhjeve të KQZ-së, raportet e gazetarëve në terren, përfshirë këtu edhe ata me të cilët organizuam punëtorinë, në 8 bashkitë e projektit.

Periodha e monitorimit përfshin, ditën e votimit dhe atë të numërimit, deri në nxjerrjen e rezultatit, ndërmejt datave 11-13 Maj 2025.

CODE Partners falenderon të gjithë vëzhguesit afatshkurtër dhe koordinatorët lokal për përkushtimin dhe integritetin e reflektuar gjatë gjithë këtij procesi.

2. Objektivat e monitorimit

- **Vlerësimi i procesit gjithëpërfshirës:** Monitorimi përfshiu fazat para-votimit (qetësia elektorale, fushata etj të raportuara nga mediat), ditën e votimit (shërbimi në qendra votimi, identifikimi biometrik), dhe numërimin e votave (të ndjekura nga VA-të)
- **Identifikimi i keqpërdorimeve:** rastet e presionit ndaj anëtarëve të komisioneve të votimit dhe numërimit, manipulimit të votës apo shantazhit.

3. Metodologjia

Gjatë muajit Janar dhe Shkurt 2025 u përgjodhen 90 VA dhe 8 koordinator lokal nga 2 qarqet Shkodër dhe Lezhë dhe 8 bashkitë e zonës së projektit, bashkia Shkodër, M.Madhe, V.Dejës, Pukë, F.arrëz, Lezhë, Mirditë dhe Kurbin.

Akreditimi dhe trajnimi i VA-ër u realizua gjatë muajit Prill 2025. Trajnime të vecanta u realizuan në secilën bashki të projektit me grupet e përzgjedhura dhe të akredituara të VA-ër. Këto trajnime u shërbyen VA-ër për t'u njohur në hollësi me rregullat dhe procedurat e parashikuara në Kodin Zgjedhor dhe njëkohësisht edhe me formularët e monitorimit.

Ndërkohë, vëzhgimi u strukturua në grupe nga 2 VA, të cilët mbuluan vëzhgimin optimalisht në 2-3 qendra votimi të vendosura në distanca të afërta nga njëra-tjetra, ose procesin e numërimit në 1 KZAZ.

Një formular tip u përgatit nga ekipi i projektit për të dy proceset, atë të votimit dhe numërimit të votave dhe u shpërnda grupeve të VA-ër nga koordinatorët lokal, për t'u diskutuar dhe sqaruar më pas gjatë trajnimeve.

Gjithashtu një plan pune, në përputhje me shpërndarjen e qendrave të votimit në cdo bashki, u punua nga koordinatorët lokal dhe j'u bë me dije grupeve të VA-ër paraprakisht. Procesi i vëzhgimit filloi për të gjithë grupet e monitorimit të procesit të votimit, ditën e zgjedhjeve, 10-15 minuta para fillimit të votimeve, për të vijuar më pas me vizita gjatë gjithë ditës nga njëra qendër tek tjetra. Ndërsa për grupet e vëzhgimit të procesit të numërimit, puna filloi menjëherë sapo përfundoi procesi i votimit. Këta të fundit ishin të vendosur pranë ambienteve të KZAZ-ve për të vëzhguar edhe procesin e mbërritjes së kutive të votimit bashkë me materialet zgjedhore.

Paraprakisht, ekipi i projektit, i pajisi të gjithë VA-ër me bexha dhe gjatë gjithë ditës komunikuan rregullisht për ecurine e procesit apo problematikat e konstatuara me koordinatorët e tyre. Grupet ishin instruktuar paraprakisht për të shmangur diskutimet në QV apo KZAZ.

Kufizimet:

- Ekipi nuk mbuloi të gjitha qendrat e votimit në 8 bashkitë e projektit (vetëm 79).

- Ekipi nuk mbuloi të gjitha qendrat e numërimit në 8 bashkitë e projektit (vetëm 9 qendra dhe 16 formular të plotësuar).
- Nuk përfshi numërim të detajuar të të gjitha votave.
- U vëzhguan më tepër çështje procedurale dhe sjellje, dhe më pak efektet afatgjata politike.
- Ekipi nuk mbuloi monitorimin e votimit të diasporës

Metodologjia e monitorimit të zgjedhjeve, u nda në dy fusha kryesore:

Metoda e fushës:

- Ekipi ynë përbëhej nga 90 vëzhgues afatshkurtër, të ndarë në 8 bashki dhe 79 qendra votimi, për të mbuluar sa më shumë territorin e dy qarqeve Shkodër dhe Lezhë
- Procesi i numërimit të votave monitorohej në 9 qendra kryesore - KZAZ.

Metoda e përgjithshme:

- Vëzhgim i përgjithshëm i 24 orëve ndaj qetësisë elektorale para ditës së votimit, marrë nga raportimet e mediave dhe gazetarëve të kontaktuar nga projekti.
- Dokumentim i incidenteve gjatë ditës së votimit dhe numërimit (intimidime, mosrespektim i rregullave, defekte teknologjike etj).
- Mbledhje e informacionit dhe draftimi i raporteve të zgjedhjeve nga koordinatorët lokal.
- Mbledhje e informacionit dhe draftimi i raportit të zgjedhjeve

4. Konteksti Politik dhe Administrativ

Zgjedhjet parlamentare në Shqipëri u mbajtën më 11 maj 2025 për të zgjedhur 140 deputetë për një mandat katërvjeçar. Për herë të parë, diaspora shqiptare mori pjesë përmes postës, duke rritur numrin e personave që e ushtrojnë të drejtën votës. Partia Socialiste synonte një mandat të katërt radhazi dhe synimin për anëtarësim në BE deri në 2030, përballë opozitës me sfida dhe me akuza për korrupsion dhe manipulim zgjedhor.

Situata politike para votimeve ishte përgjithësisht e qetë dhe e paraprirë nga një marrëveshje ndërmjet forcave politike për disa përmirësime në kodin zgjedhor, përfshirë këtu edhe votimin e emigrantëve. Megjithatë nuk munguan akuzat nga opozita për VKM që parashikoi bonusin e pensionistëve dhe faljen e gjobave dy ditë përpara zgjedhjeve, një vendim që fali një sërë gjobash dhe masash administrative të vendosura ndër vite ndaj qytetarëve dhe bizneseve, duke i konsideruar këto veprime si në kundërshtim me rregullat e Kodit Zgjedhor.



Veprimtaria e partive politike në qarqet përkatëse të projektit ka qenë në përputhje me rregullimet e kodit zgjedhor duke respektuar rregullimet e kodit zgjedhor për fillimin dhe mbylljen e fushatës, promocionin e fushatës, organizimin e aktiviteteve etj.

Gjatë fushatës zgjedhore në zonën e projektit nuk ka patur raportime për incidente apo përplasje ndërmjet forcave politike, përfaqësuese të tyre ose simpatizanëve. Fushata ka qenë në shumicën e kohës e qetë, e raportuar kjo edhe nga mediat lokale dhe kombëtare por edhe nga trupa e gazetarëve të takuar në kuadër të projektit.

5. Administrimi i zgjedhjeve

5.1. Dita e Votimit – 11 Maj 2025

5.1.1 Hapja e Qendrave të Votimit

Orari zyrtar i hapjes së QV ishte ora 07:00. VA-ër të angazhuar në project, të instruktuar nga ekipi i projektit dhe gjatë trajnimeve, ishin të pranishëm në shumicën e rasteve 10-15 minuta para fillimit të procesit të votimit, për të ndjekur nga afër procesin e hapjes së QV, funksionimin e pajisjeve PEI, kamerave, listat e votuesve, përbërjen e komisionit dhe materialet zgjedhore.

Pergjithësisht, QV u hapen të gjitha në orën e përcaktuar, me përjashtime të vogla, por që gjithsesi nuk cënuan procesin dhe nuk krijuan radhë për votuesit apo konfuzion. Materialit zgjedhore në të gjitha rastet kishin mbërritur në QV, 1 ditë më përpara dhe në të gjitha rastet komisionet e QV ishin të përqendruar në vënien në funksion të tyre. Të gjitha qendrat ishin të pajisura me pajisje PEI dhe kamera dhe të gjitha komisionet punuan paraprakisht për sistemimin e materialeve zgjedhore në përputhje me procesin dhe kërkesat e kodit zgjedhor. Vonesa të vogla/shkurtëra në shumicën e rasteve erdhen si pasojë e trajnimit jo të mjaftueshëm të anëtarëve të komisioneve të QV-vë, ndërkohë kishte raste kur komisionerët u paraqiten me vonesë në QV.

Nderkohe që ne të gjitha qendrat e votimit ishin/u vendosen materialet informuese për mënyrën e votimit. Të gjitha materialet zgjedhore në QV e vëzhguara ishin pranuar dhe administruar në respektim të ligjit, rregulloreve dhe urdhërave të brendshëm të KQZ, duke mos shfaqur asnjë problematikë as në mjetet e tipit fletë votimi, dhomat e fshehta, shënjes gishti, etj. dhe as në mjetet teknologjike si pajisja PEI dhe kamera. Në të gjitha QV e vëzhguara është ndezur kamera nga operatori, përpara se të bëheshin veprime të tjera për hapjen e QV.

Forcat e rendit kanë qenë prezent gjatë periudhës së hapjes së qendrave të votimit dhe janë larguar kur ka filluar procesi i votimit

- Probleme të raportuara gjatë hapjes së qendrave të votimit (vonesa, mungesë materiali, mosfunksionim pajisjesh, etj.)

- Në dy QV 0856, QV 0856/1, një pjesë e anëtarëve nuk erdhën gjatë gjithë ditës. QV në fjalë u hapën pasi u mor konfirmimi nga KZAZ për të vazhduar me procedurat dhe për t'a bërë QV funksionale për zgjedhësit.
- Në vetëm 1 rast është konstatuar që dhoma e votimit nuk ishte qartësisht dhe plotësisht e larguar nga dritarja e ambienteve ku ishte vendosur QV.
- Në disa raste, QV nuk u hapen në orarin e parashikuar, me vonesë të vogla por pa cenuar procesin
- Qartësisht shumë komisioner/e kishin nevojë për më shumë njohuri dhe trajnim për aspektet e administrimit të materialeve zgjedhore dhe votimit.
- në qendrën 251 Shkodër, kamera ka filluar të punojë me pak vonesë dhe ka patur probleme teknike gjatë gjithëditës

5.1.2 Procesi i Votimit

- Rregullsia e procesit

Në përgjithësi procesi i votimit, në qendrat e monitoruara, ka qenë i qetë dhe i rregullt. Nuk janë evidentuar në asnjë QV të vëzhguar persona të paautorizuar, forma të ndryshme të ushtrimit të presionit apo të bërit fushatë për të ndikuar zgjedhësit. Frekuentimi i votuesve ka patur luhajtje sipas orëve të ditës dhe është konstatuar që oraret e mesditës nuk kishin numër të lartë votuesish në qendrat e votimit. KQV nuk ka lejuar që në dhomat e fshehta të votimit të ketë më shumë se një votues, përveçse në rastet kur një familjar ndihmonte një të moshuar, por edhe kjo vetëm një herë.

Ambientet e QV kanë qenë në përputhje me standartet e Kodit Zgjedhor, përveç QV 0856 ku njëra nga dhomat e fshehta të votimit ishte afër dritares, gjë e cila u rregullua gjatë ditës. Të gjitha materialet udhëzuese janë afishuar në të gjitha QV e vëzhguara, ndërsa në një rreze 150 metra në ambientet e jashtme të QV nuk janë parë materiale propagandistike të partive politike apo kandidatëve. Gjithashtu nuk është konstatuar asnjë rast i prezencës të personave të paautorizuar në asnjë QV.

Në disa raste u evidentuan problematika të lehta që nuk ndikuan në integritetin e procesit, si ndihmë e pajustificuar për votues të moshuar apo tentativa për komunikim me votuesin brenda kabinës, të cilat u adresuan nga komisionerët menjëherë dhe pa tensione.

Frekuentimi i votuesve në qendrat e votimit ka pasuar një rritje graduale gjatë gjithë ditës, me një intensifikim të dukshëm në mesditë dhe në orët e pasdites, çka përputhet me tendencat e zakonshme të pjesëmarrjes në zona rurale dhe urbane të përziera. Në përgjithësi pjesëmarrja ka qenë e qëndrueshme dhe e përhapur në mënyrë të balancuar gjatë ditës, pa ndonjë valë të papritur apo bllokime. Tendencë ka qenë në përputhje me zgjedhjet e mëparshme, me një angazhim më të madh në orët e pasdites.

Gjatë gjithë ditës së votimit janë konstatuar një numër jo i lartë i vëzhguesve të pavarur dhe përgjithësisht komisionet në QV nuk verifikuan ligjshmërinë e tyre.

Pajisjet për identifikimin biometrik të zgjedhësve dhe kamerat kanë punuar pa probleme në të gjitha QV. Nuk ka patur ndërprerje të sinjalit dhe funksionimit të tyre në asnjë rast gjatë gjithë ditës.

Megjithatë ka patur edhe raste që monitoruesit kanë konstatuar parregullsi, si psh në Bashkinë Lezhë, qendrën e votimit 47/002 dhe 47/01 ku në total 8 raste në dhomen e votimit kanë qenë më shumë se një person pa qenë nevoja dhe në 2 raste kishte persona të paautorizuar në QV; dhe gjatë orës së fundit të procesit të votimit, votuesve nuk u është vënë shenja në gisht.

Në Shkodër, qendra nr 251 situatë ka qenë pak e paqartë, pasi lista hard copy e votuesve mungonte.

- Probleme të hasura (tentativa për influencim, votime familjare, ndihmë të pajustificuar, etj.)

QV 0856 njëra nga dhomat e fshehta të votimit ishte afër dritares, gjë e cila u rregullua gjatë ditës. U konstatuan raste sporadike si ndihmë e pajustificuar për votues të moshuar apo tentativa për komunikim me votuesin brenda kabinës, të cilat u adresuan nga komisionerët menjëherë, pa tensione dhe nuk ndikuan integritetin e procesit.

5.1.3 Mbyllja e Qendrave të Votimit

Të gjitha QV e vëzhguara janë mbyllur në orarin zyrtar 19:00. Në asnjë nga QV nuk kishte qytetarë që prisnin në radhë për të votuar në momentin e mbylljes.

Mbyllja e procesit të votimit në qendrat e vëzhguara është realizuar në përputhje me udhëzimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me respektim të hapave standardë dhe pjesëmarrje të aktorëve përkatës në çdo fazë.

Procedurat e mbylljes janë bërë sipas standarteve të Kodit Zgjedhor,. Shpesh anëtarë të KQV dilnin nga QV për të asistuar anëtarët e një KQV tjetër në lidhje me procedurat e mbylljes. Kjo ka ndodhur në QV që ndodhen në të njëjtën ndërtesë dhe kat, pra asnjëherë anëtarët e KQV të vëzhguara nuk janë larguar nga QV. Një parregullsi ka ndodhur në QV 0857/1 ku materialet zgjedhore janë administruar për mbyllje, pasi është fikur kamera nga operatori.

Orari i përfundimit të votimit u respektua, përveç rasteve të lejuara me vonesa minimale për votuesit që ndodheshin në ambientet e jashtme në momentin e mbylljes. Komisionerët bënë mbylljen elektronike të pajisjes së identifikimit (PEI) dhe siguruan pajisjen sipas udhëzimeve. Fletët e pavotuara u numëruan, vulosën dhe u paketuan. U mbyllën zyrtarisht të gjitha materialet zgjedhore: kutitë e votimit, regjistrat, procesverbalet, listat e votuesve, të gjitha të sistemuara dhe të paketuar sipas formularëve përkatës të KQZ-së. Procesverbalet e mbylljes u firmosën nga të gjithë anëtarët e komisionit. Materialet u vendosën në kuti të vulosura sipas procedurës dhe u dorëzuan me përcjellje të sigurt drejt Qendrave të Numërimit.

Në disa qendra, për arsye terreni, transportimi u realizua me ndihmën e forcave të rendit apo policisë bashkiake, gjithmonë nën mbikëqyrje të komisionerëve dhe vëzhguesve.

Prania e vëzhguesve ka qenë e ulët ndërkohë që nuk është konstatuar prezence e personave të paautorizuar. Gjatë fazës së mbylljes së votimit në QV e vëzhguara kanë qenë prezent vëzhgues të akredituar dhe përfaqësues të partive politike, duke garantuar një proces transparent dhe të monitoruar në të gjitha aspektet.

5.2. Dita e Numërimit – 12 Maj 2025

5.2. 1 Organizimi i Numërimit

Procesi i dorëzimit të kutive të votave dhe materialeve të votimit filloi menjëherë pas mbylljes së procesit të votimit. Ky proces nuk kishte kontestime ose parregullsi, por verifikimi i vulave dhe bazës tjetër materiale vijoi me ritëm të ngadaltë, duke bërë që KQV i fundit të dorëzojë materialet pas mesnate.

Procesi i numërimit të votave për të gjitha qendrat e votimit të zonës së projektit u zhvillua në një vend të përqendruar, sipas përcaktimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). Në këto ambiente u krye numërimi i të gjitha kutive të votimit të ardhura nga QV-te.

Në ambjentet e KZAZ-ve ishin vendosur postera që sqarojnë rastet e fleteve të votimit të vlefshme dhe të pavlefshme.

Në qendrat e numërimit, ka patur prani të vëzhguesve të OSBE-së, të OJF-ve, të subjekteve dhe koalicioneve politike të gjithë të akredituar.

5.2.2 Procesi i Numërimit

Procesi i numërimit nisi menjëherë pas përfundimit të dorëzimit të kutive nga komisionet e qendrave të votimit. Komisionet e Numërimit të Votave (KNV-të) vepruan sipas procedurave të përcaktuara nga Kodi Zgjedhor dhe aktet nënligjore të KQZ-së. Në përgjithësi, procesi është konsideruar i rregullt dhe transparent, me respektim të standardeve ligjore dhe pa ndërprerje të pajustificuara.

KZAZ-të plotësonin të gjitha standartet e vendosura në Kod Zgjedhor, duke siguruar distancë mes GNV dhe vëzhguesve, vendin e numërimit të organizuar në GNV, vendgrumbullimin e kutive që presin të numërohen dhe atyre që janë numëruar, sekretariati, etj. Procesi i numërimit në përgjithësi vijoi me qetësi dhe pa shumë kontestime, por sidoqofte me ritme shumë të ngadalta. Në rastet kur kishte kontestime, numëruesi i parë ngrinte dorën dhe njoftonte kryetarin dhe sekretarin e KZAZ, të cilët afroheshin për të gjykuar çështjen. Në rastet kur vullneti i zgjedhësit nuk ishte i qartë nga shënimi që kishte vënë në fletë, kryetari dhe sekretari vendosnin se si do të numërohej kjo votë dhe njoftonin GNV dhe vëzhguesit për këtë, duke theksuar dhe elementin e precedentit që duhej ndjekur në raste të ngjashme. E gjithë kjo bëhej në qetësi

dhe pa shqetësuar grupet e tjera të numërimit. Ndonëse në ambientet e brendshme të KZAZ kishte një numër jo të vogël të njerëzve të paautorizuar, situata ishte e qetë.

Nuk janë konstatuar probleme apo vonesa gjatë procesit të numërimit. Në disa raste, procesi është ndërprerë me konsensus pas numërimit të votave për subjektet politike për të rinisur pas pushimit, numërimi i votave preferenciale.

5.2.3 Rezultatet Paraprake

Pas përfundimit të numërimit të votave, rezultatet paraprake u shpallën nga Komisionet Zonale të Administrimit të Zgjedhjeve në përputhje me afatet dhe procedurat ligjore. Nuk u evidentuan shkelje apo parregullsi që të kompromentonin / ndikonin rezultatin zgjedhor në nivel qarku apo njësie votimi. Në disa raste, vëzhguesit e partive politike shprehën pakënaqësi në lidhje me procedurat e ndjekura gjatë numërimit, ku pati pretendime për mungesë transparence në momente të caktuara, vecanërisht për votat preferenciale, por nuk u paraqitën prova dhe as nuk u konstatuan shkelje.

6. Vlerësime dhe Konkluzione

Në përgjithësi, dita e votimit në të gjitha QV dhe QNV e dy qarqeve, zonë e projektit, ka qenë e qetë. Qendrat e votimit, ato të numërimit dhe ambientet përkatëse kanë qenë në përputhje me rregullimet, kërkesat dhe standardet e ligjit. Procesi i votimit ka filluar dhe përfunduar përgjithësisht sipas orarit të përcaktuar, me përjashtime të rralla, kur komisioni i QV u paraqit me vonesë apo nuk ishin të qartë për procedurat e hapjes së QV-ve si pasojë e trajnimeve jo të mjaftueshme. Komisionerët e QV dhe GNV ishin përgjithësisht të kualifikuar për të kryer punën e ngarkuar, megjithëse në disa raste u konstatua se njohuritë nuk ishin në nivelin e duhur. Sidoqoftë, për rastet kur informacionet nuk ishin sic duhet, trupat përkatëse kërkuar gjithmonë mbështetje nga kryetari dhe sekretari i KZAZ.

Materialet zgjedhore u administruan me korrektësi, ndërsa u konstatua që numri i vëzhguesve të pavarur të akredituar ishte relativisht i ulët.

Votimi nisi në kohë në shumicën e qendrave, komisionerët ishin të pranishëm, materialet ishin të plota dhe nuk pati incidente. Frekuentimi i votuesve ishte mesatar dhe i përqendruar në orët e paradites dhe të pasdites së vonë. Vëzhguesit e akredituar dhe përfaqësuesit e partive politike kanë ndjekur procesin pa raportuar shkelje që çënojnë procesin.

Procesi i dorëzimit të materialeve zgjedhore dhe kutive të votimit pranë KZAZ-ve ishte relativisht i gjatë, dhe sfilitës.

Ndërkohë, numërimi i votave u zhvillua në mënyrë të përqendruar në KZAZ-te e përcaktuara. Procesi është zhvilluar në përputhje të përgjithshme me Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, si dhe me



Funded by
the European Union



IPLS | institute for policy
& legal studies



udhëzimet përkatëse të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), duke filluar me numerimin e votave për subjektet politike e me pas vota preferenciale për kandidatet.

Rregullat e parashikuara në Kodin Zgjedhor nuk e ndaluan Qeverinë që me vendimet e saj për faljen e gjobave dhe bonusin e pensionistëve, të ndikojë elektoratin.

Rekomandime për përmirësime në proceset e ardhshme zgjedhore janë:

- Përmirësimi i logjistikës në zonat e largëta rurale;
- Trajnim më i thelluar për komisionerët, kryesisht atyre të qendrave të votimit;
- Rritja e transparencës në procesin e numërimit të votave;
- Depolitizim i administratës zgjedhore



Funded by
the European Union



IPLS | institute for policy
& legal studies



7. Aneksë

RAPORT MONITORIMI

Zgjedhjet e Përgjithshme Parlamentare 2025

Qarku Shkodër dhe Qarku Lezhë

Aneks 1

Lista e qendrave të votimit të vëzhguara

Bashkia M.Madhe –	QV 49/02; 48/01; 47/01; 0020; 49/02; 47/02; Selce; 49/03; 0003; (9)
Bashkia Shkodër –	QV 292; 293; 259; 295; 250; 250/1; 251; 305/1; 305; 313; 315/1; 315 (12)
Bashkia V.Dejës -	QV 182; 183; 181; 158; 209; 210; 211; 212; 150; 151; 152; 145; 146 (13)
Bashkia Pukë -	QV 392; 394/1; 425; 430; 07; 393; 391 (7)
Bashkia F.Arrëz -	QV 0349; 0353; 0354; 0366; 0367; 0368; 0369; 0398; 0399; 0404; 0355; 0363 (12)
Bashkia Lezhë -	QV 0744; 0729/4; 0742; Shkolla e Bashkuar; Bar Nikolin Cuni Rr Skenderbeg (5)
Bashkia Mirditë -	QV 827; 741; 0834; 0825/1; 0816/1; 0842; 0795; 0900/1; 0900/3; 0931/3; 0835; 0837; 0810; (13)
Bashkia Kurbin -	QV 0856/1; 0851; 0856; 0857/1; 0857; 0913; 0913/1; 0812 (8)

Në total, u vëzhguan 79 qendra votimi, të ndara 53 në qarkun Shkodër dhe 26 në qarkun Lezhë



Funded by
the European Union



IPLS | institute for policy
& legal studies



RAPORT MONITORIMI

Zgjedhjet e Përgjithshme Parlamentare 2025

Qarku Shkodër dhe Qarku Lezhë

Aneks 2

Lista e qendrave të numerimit të vëzhguara

Bashkia M.Madhe –	KZAZ 1; KZAZ 1;
Bashkia Shkodër –	KZAZ 2; KZAZ 4;
Bashkia V.Dejës -	KZAZ 6; KZAZ 6;
Bashkia Pukë -	KZAZ 7; KZAZ 7; KZAZ 7; KZAZ 7
Bashkia F.Arrëz -	KZAZ 8
Bashkia Lezhë -	KZAZ 12; KZAZ 12; KZAZ 12;
Bashkia Mirditë -	KZAZ 14;
Bashkia Kurbin -	KZAZ 15;

Në total, u vëzhguan 9 qendra të numerimit, të ndara 6 në qarkun Shkodër, përfshirë këtu 11 formular monitorimi të plotësuar nga vëzhguesit dhe 3 qendra të numërimit në qarkun Lezhë, përfshirë 5 formular vëzhgimi.